



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:100244  
Datë: 05.06.2024  
Numri i dokumentit: 05783092

**K.DH.Shk II.nr.655/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës, Sh.a në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, Drejtoria e Arsimit me adresë në rr. “Bedri Gjinaj”, pn, në Mitrovicë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Lirim Zeka nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.2631/22 të datës 23.10.2023, me datë 05.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës, Sh.A ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 2631/22 të datës 23.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 2631/22 të datës 23.10.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të Komuna e Mitrovicës, Drejtoria e Arsimit të ushtruar kundër Urdhrit

për Përmbarrim P.nr. 410/2022 i datës 02.12.2022 të Përmbarruesit Privat rivat Ilmi Miftaraj, dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim në pikën I të dispozitivit është Anuluar,

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 2631/22 të datës 23.10.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pabazuar si dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 2631/22 të datës 23.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori S Telekomi i Kosovës, Sh.a në Prishtinë, me datën 02.12.2022, ka paraqitur propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, të dokumentit - Faturës nr. 191030092619 me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 561.95 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor duke theksuar se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbarrimore nuk është e përshtatshme për përmbarrim pasi që nuk ka qenë e nënshkruar e as e vulosur nga personi kompetent pranë debitorit andaj e njëjta është në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës, që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri përmbarrimor P.nr.410/2022 i datës 02.12.2022 të anulohet. Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur

brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar duke deklaruar se debitori është njoftuar me faturat për pagesën e borxhit sepse debitori ka pranuar faturën çdo muaj nëpërmjet emailit. Ka shtuar se kreditori ka kërkuar vazhdimisht që kërkesa të realizohet e kjo vërtetohet me korrespondencën e datës 06.10.2022, të datës 30.08.2022, 12.08.2022 etj. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa themeltë prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor i lartcekur.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Shkalla e Parë duke u bazuar në të lartcekurat si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura nr. 191030092619 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin e debitorit dhe as vulën e pranimit të shkresave të debitorit si institucion, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohej se fatura është dorëzuar me rregull dhe është pranuar nga ana e debitorit. Andaj Gjykata vlerëson se Komuna e Mitrovicës nuk e ka cilësinë e debitorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, element ky që kërkohet sipas nenit 29.3 të LPP-së, andaj i njëjti nuk obligohet në pagimin e detyrimit që rrjedh nga fatura e lartcekur në këtë procedurë përmbarimore.

Po ashtu shkalla e parë vlerësoi pretendimin e kreditorit se fatura në rastin konkret i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit përmes komunikimit elektronik – e-mail, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar për faktin debitori, përmes zyrtarit G.S, në komunikimin

elektronik të datës 30.08.2022 ka njoftuar kreditorin se nuk mund të procedoj me pagesat e faturave për periudhën e gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021, për faktin se të njëjtat nuk janë dorëzuar me rregull dhe protokolluar nga ana e debitorit në mënyrë që të procedohet me pagesën e tyre, e rrjedhimisht, nga ky komunikim, rezulton se debitori ka kundërshtuar pranimin e faturës mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi.

Tutje, Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm - faturës, dhe përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Andaj Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, vlerëson se të metat e theksuara si më lartë kanë mundur të trajtohet nga organi përmbarues, përkatësisht nga përmbaruesi privat dhe atë para lejimit të urdhrit, në kuptim të nenit 38, paragrafi 2 i cili, me të cilin përcaktohet se “Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se fatura si dokument i besueshëm, - Faturës nr. 191030092619 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.DH.SH.II.nr.655/24, me datë 05.06.2024**

**Gjyqtarja,  
Saranda Bogaj Sheremeti**